



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Prishtinë, 16 Shtator 2017

Komunikatë për medie

Kandidatet e subjekteve politike për anëtarë të Kuvendeve Komunale dhe për Kryetar të Komunës të cilët kanë qenë të certifikuar nga KQZ-ja për të marrë pjesë në Zgjedhjet Lokale të 22 tetorit 2017, në Institucionin e PZAP-it kanë parashtruar gjithsejtë shtatëmbëdhjetë (17) ankesa/apelë kundër vendimit të KQZ-se për decertifikimin e tyre nga lista kandidatëve.

Ankesa/apelë kanë parashtruar kandidatet nga radhët e subjekteve politike si në vijim:

1. Partia Shqiptare Demokristiane - PSHDK – dega në Gjakovë. **2 apelë,**
2. Partia Demokratike e Kosovës - PDK – dega në Ferizaj 1 apel, dega në Mitrovicë 1 apel, dega në Malishevë 2 apelë, dega në Podujevë 1 apel, dega në Shtime 1 apel dhe dega në Prishtinë 1 apel. **Gjithsejtë 7 apelë.**
3. Lidhja Demokratike e Kosovës – LDK – dega në Dragash, 1 apel, dega në Kamenice 1 apel, dega në Istog 1 apel dhe dega në Gjilan 1 apel. **Gjithsejtë 4 apelë.**
4. NISMA për Kosovën – dega në Prizren 1 apel, dega në Vushtrri 1 apel dhe 1 apel dega në Fushë Kosovë. **Gjithsejtë 3 apelë.**
5. Aleanca Kosova e Re – AKR, dega në Shtime, **1 apel,**

PZAP-i, brenda afatit ligjor i ka shqyrtuar dhe vendosur të gjitha ankesat/apelët që lidhen me decertifikimin e kandidatëve dhe ka marrë vendim për refuzimin e ankesave dhe apeleve **si të pabazuara.**

Prej 17 kandidatëve të cilat kanë parashtruar ankesa 13 janë njoftuar me vendimet e PZAP-it, ndërsa 4 kandidatë ende nuk janë njoftuar me vendimet dhe sa më parë që është e mundur do të njoftohen.

Njoftohen kandidatet se kundër vendimit të PZAP-it është e lejuar ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.